

VENDIM
Nr. 12, datë 20.1.2021

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË
LIDHJE ME KËRKESËN E SHOQËRISË “SEMAN SUNPOWER” SHPK, PËR
TRANSFERIM TË ASETEVE (VENDOSJE HIPOTEKE) NË FAVOR TË “INTESA
SANPAOLO BANK” SHA**

Në mbështetje të nenit 16, të nenit 20, germa “a”, të nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; pikat 1.3, dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; të nenit 7 dhe të nenit 11, pika 1, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 9/1 prot., datë 14.1.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 189, datë 19.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k. për transferim të aseteve (vendosje hipoteke), në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.

- Në vijim të sa më sipër, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1163/1 prot., datë 11.12.2020, duke i njoftuar fillimin e procedurës, dhe i kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar nga aplikimi i saj.

- Me shkresën nr. 3 prot., datë 14.1.2020, shoqëria ka paraqitur në ERE kërkesën për shtyrje të afatit, për plotësimin e dokumentacionit, për arsye se ajo e ka pasur të pamundur të plotësojë në afat dokumentacionin e konstatuar të munguar për shkak të periudhës së pandemisë *COVID-19*, e cila ka shfaqur pengesa për të vazhduar me ndjekjen e procedurave pranë institucioneve për dokumentacionin e kërkuar, kohës së zgjatur të pushimeve në ndërrimin e viteve, si dhe vonesave të shkaktuara për marrjen e dokumentacionit nga banka e cila ka financuar projektin, për ta paraqitur pranë ERE-s.

- Në nenin 10, pika 3, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve të të licencuarve”, përcaktohet se në rastin e transferimit të aseteve nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike me kapacitet më të madh se 10 mw, apo nga centralët në sektorin e gazit me vlerë më të madhe se 2.000.000.000 lekë, afati i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, është 60 ditë sektorin e, ndaj për kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k. Bordi duhet të marrë vendimin përfundimtar brenda datës 21.1.2021

- Në nenin 53, pika 3, të “Kodit të procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se:

- “Afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Duke qenë se kërkesa e shoqërisë, për zgjatje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës, është bërë e arsyetuar dhe përpara mbarimit të afatit për vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s, vlerësojmë se kërkesa e saj duhet të pranohet dhe të zgjatet afati i trajtimit final të praktikës me 30 ditë pune.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” shpk., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke) në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti